

## PROJEKTI I FEDERATËS BALLKANIKE NË MARRËDHËNIET SHQIPTARE – JUGOSLLAVE NË 1945-1948 BALKAN FEDERATION PROJECT IN THE ALBANIAN-YUGOSLAV RELATIONS (1945-1948)

BRISEJDA LALA

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Histori Filologjisë, Tiranë, SHQIPËRI

E mail: brisejda.lala@gmail.com

AKTET VI, 5: 486-490, 2013

### PËRMBLEDHJE

Tema “Projekti i federatës ballkanike në marrëdhëniet shqipëtare - jugosllave në vitet 1945-1948” ka qëllim të paraqesë një pjesë të historisë së marrëdhënieve bilaterale Shqipëri-Jugosllavi. Kjo periudhë ka rëndësi studimi pasi mund të themi se Jugosllavia kishte si synim kryesor përfshirjen e Shqipërisë në Konfederatën Ballkanike. Qeveria jugosllave duke shfrytëzuar vështirësitë që po kalonte vendi, në gjysmën e dytë të vitit 1947 e rriti tryshinën mbi udhëheqjen shqiptare, me qëllim që të likuidonte pengesat e t’i hapte rrugë projektit për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, si republikë e shtatë e saj; ose dhe në kuadrin e Federatës Ballkanike, që parashikohej të krijohej. Shqipëria, nga ana e saj ishte e pakënaqur nga pala jugosllave. Presioni që ushtronte qeveria jugosllave tek qeveria shqiptare, për ta përfshirë atë në Federatën Jugosllave ishte i padurueshëm, ndaj dëshira e udhëheqësve shqiptarë ishte distancimi nga Jugosllavia.

**Fjalët çelës:** Konfederata, marrëdhënie bilaterale, vijë antijugosllave, federate

### SUMMARY

The topic “Balkan Federation Project in the Albanian-Yugoslav Relations (1945-1948)”, intends to present a brief history of bilateral relations between Albania and Yugoslavia. This period is important too study because we can say that the objective of Yugoslavia was as main the inclusion of Albania in the Balkan Confederation. The Yugoslav government by utilizing the economic difficulties during the second period of 1947, increased the pressure on the albanian leadership, in order to open the way for the project to merge Albania with Yugoslavia, as its seventh republic or in the Balkan Federation, who predicted to be created. On the other hand Albania was dissatisfied by the Yugoslavs. Yugoslav government exerted pressure on the albanian government to include it in the Yugoslav Confederation, so the desire of the Albanian leaders was to sever relations with Yugoslavia. To shed light on the Yugoslavian project to include Albania in the Balkan Confederation and the Albanian government position on this issue will be the core of this work that I undertook.

**Keywords:** Confederation, federation, bilateral relations, anti-yugoslav.

---

### Hyrje

Pas Luftës së Dytë Botërore, Jugosllavia ishte vendi i parë që njohu qeverinë shqiptare dhe vendosi marrëdhënie diplomatike me të. Si rezultat i ftohjes me Perëndimin orientimi i ri i Shqipërisë do të ishte kah fuqitë komuniste dhe, meqenëse Moskë nuk shfaqte ndonjë interes të veçantë për Shqipërinë, kjo e fundit u detyrua të

lidhte marrëdhënie të ngushta me Jugosllavinë fqinje.

Bashkëpunimi ndërmjet dy partive komuniste të vendeve respektive ishte i madh, mjaft jugosllavë u vendosën në institucionet e shtetit tonë në cilësinë e ekspertëve. “Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u forcuan edhe me tepër pas vizitës që Enver Hoxha bëri në Jugosllavi, më 23 qershor-2

korrik 1946” (ASHSH 2008: 242). Gjatë kësaj vizite dy vendet nënshkruan një marrëveshje ekonomike ndërmjet tyre. Ndihamat që vinin nga Jugosllavia ishin të domosdoshme për Shqipërinë e pas luftës. Vendi nuk kishte kapacitetet e nevojshme për të rindërtuar vendin, për më tepër ajo refuzoi edhe ndihmat që mund të vinin nga “Plani Marshall”. Në kushte të tilla Shqipëria u mundua të siguronte ndihmat e nevojshme nga fqinji i saj, Jugosllavia. Këto ndihma u ndoqën nga një varg marrëveshjesh ekonomike. Më 9 Korrik 1946 në Tiranë ndërmjet dy vendeve u nënshkrua Traktati i Miqësisë dhe Ndihamës Reciproke sipas të cilit palët kontratuese zotoheshin të ndihmonin njëra tjetrën në rast agresioni nga jashtë. Pa kaluar shumë kohë, më 27 nëntor 1946, dy vendet vendosën të “përfundojnë një Traktat Koordinimi të planeve ekonomike, bashkimit doganor dhe barazimit të monedhave” (Malltezi& Plasari 1996: 62). Zbatimi i këtyre marrëveshjeve nuk rezultoi aq i thjeshtë sa nënshkrimi i tyre pasi qeveria Jugosllave kërkonte ta vinte ekonominë shqiptare nën funksion të ekonomisë jugosllave dhe synimi përfundimtar i kësaj të fundit ishte afirmimi dhe përfshirja e Shqipërisë brenda Federatës Jugosllave”(ASHSH 2008: 238).

### **Historiku i lindjes së idesë**

Sipas Gurakuqit (2011) koncepti i parë për krijimin e një federate të tillë paraqitet në vitet '60 të shekullit XIX. Ky shtet i madh ballkanik, i cili do të përfshinte vendet e Jugosllavisë, Bullgarinë dhe Shqipërinë u quajt BALLKANIA. Idetë për krijimin e Federatës Ballkanike janë shfaqur edhe në shekullit XX gjatë zhvillimit të Konferencave Ballkanike të viteve 1933-1934. Pas Luftës së Dytë Botërore, J. B. Tito-ja dhe disa udhëheqës të tjerë të Evropës Lindore, shqyrtuan mundësinë e bashkimit të shteteve të gadishullit dhe formimin e një republike federative të Ballkanit. Me rritjen e ndikimit të jugosllavisë në politikën e brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë dukej sikur synimi i Titos dhe qeverisë së tij ishte më i mundshëm se kurrë.

Në vitin 1947 marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u lëkundën dukshëm pasi kishin lindur mosmarrëveshje të shumta në lidhje me zbatimin e

marrëveshjeve ekonomike dhe politike. “Nga fundi i qershorit 1947 jugosllavët, për herë të parë, ngritën zyrtarisht akuzën se në kreun e shtetit shqiptar po kristalizohej një vijë e dytë antijugosllave”(ASHSH 2008: 243). Sa më shumë kalonte koha aq më tepër rritej presioni i Jugosllavisë mbi udhëheqjen shqiptare në lidhje me mosmarrëveshjet e krijuara ndërmjet tyre. Pikërisht për këto arsye E. Hoxha kërkonte me këmbëngulje të shkonte në Moskë. “Vizita e delegacionit qeveritar shqiptar në BRSS, në korrik të vitit 1947, nuk kaloi pa u vënë re në Beograd. U ndje kërcënimi për “monopolin e miqësisë” me Shqipërinë i vendosur në marrëdhëniet e ndërsjella midis dy vendeve, i nxitur, sipas tyre nga pala sovjetike” (Smirnova 2004: 326). Në këtë kohë ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj jugosllave kishin nisur mosmarrëveshjet për çështje të ndryshme, Hoxha po e ndjente tashmë se fundi i këtyre marrëdhënieve, në dukje miqësore ishte afër.

Pa kaluar shumë kohë, në fillim të nëntorit të po këtij viti KQ i PKJ i përcolli udhëheqjes së PKSH akuzën e dytë, në lidhje me lindjen e një qëndrimi e të një orientimi antijugosllav te disa prej anëtarëve të Byrosë së PKSH, duke përmendur këtu edhe emra konkretë. Kjo deklaratë e qeverisë jugosllave u shoqërua me vetëvrastjen e Nako Spiros, i cili u akuzua nga Komiteti Qendror i PKSH si përgjegjës për vështirësitë e krijuara në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve dhe për sabotimin e vijës së drejtë që ndiqte PKSH.

“Në klimën e krijuar pas Plenumit, udhëheqja jugosllave shtoi trysninë mbi udhëheqjen e PKSH të Shtetit Shqiptar, me qëllim që të realizohej sa më shpejt bashkimi i Shqipërisë me Jugosllavinë” (ASHSH 2008: 250). Duke shfrytëzuar vështirësitë Brenda KQ të PKSH më 5 dhjetor 1947 i dërguari i KQ të PKJ, Savo Zllatiç, i parashtroi E. Hoxhës tezën dhe idenë e krijimit të një Federate Ballkanike, e cila do përfshinte në të edhe Bullgarinë. Më vonë vetë ai pohon se “për Bullgarinë mund të thuhet se mund të rrojë vetëm, kurse për Shqipërinë jo. Edhe kjo nuk është presion që i bëhet Shqipërisë, por se kështu është e vërteta, kështu janë konditat” (Marrëdh. Shq. Jugosll.: 140), ndaj “në këto baza praktikisht federata (do

të ngrihet) në radhë të parë në sektorët ekonomikë” (Malltezi & Plasari 1996: 135).

Më 17 Dhjetor, tezat e paraqitura nga S. Zllatiç do të shqyrtoheshin në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ Të PKSH, vetë Hoxha do të shprehet: “Marrëdhëniet duhet t’i shikojmë midis dy vendeve tona dhe me popullin bullgar. Në praktikë duke punuar kështu, ne punojmë për Federatën Ballkanike, ndërtojmë themelet e kësaj federate, sigurojmë bashkimin e vërtetë. Duke punuar në baza federative, praktikisht shkojmë drejt bashkimit të vërtetë, pavarësisht se nga ana formale do të ruhet shteti me ministri të jashtme. Duhet mbajtur vetëm format e jashtme, si independenca, ministritë e jashtme, por politika e jashtme do të jetë në baza të përbashkëta, e orientuar nga Bashkimi Sovjetik” (Malltezi & Plasari 1996: 141).

Në këto rrethana Byroja Politike i miratoi propozimet e përfaqësuesit jugosllav duke vënë në rrezik pavarësinë e shtetit shqiptar. Më tej zhvillohen bisedime ndërmjet dy vendeve për bashkimin e Ushtrisë Shqiptare me Ushtrinë Jugosllave në një komandë të përbashkët, duke e çuar më tej idenë e bashkimit të dy vendeve. Në 26 Janar 1948 Tito i dërgon letër E. Hoxhës me anë të të cilës kërkonte vendosjen e një divizioni ushtarak në Korçë. Siç bën të ditur Hoxha në mbledhje të byrosë pol kjo kërkesë u pranua nga pala shqiptare, e cila menjëherë njoftoi Bashkimin Sovjetik: “ne i kishim njoftuar se prisnim urdhrat për të lëvizur forcat, sipas bisedimit me jugosllavët. Më vonë nga Beogradi vjen urdhëri që plani të ndalohet dhe ne e lamë” (Malltezi & Plasari 1996: 403).

Në mars 1948 në një mbledhje të Byrosë u shtrua çështja e bashkimit të vendit me Jugosllavinë. Madje siç deklarojnë anëtarët e byrosë Dimitrovi i nxitë shqiptarët që të kërkojnë bashkimin duke pohuar se meqë ju jeni më afër, duhet ta shtroni më parë se Bullgaria këtë çështje (Malltezi & Plasari 1996: 407). Në të vërtetë, Bullgaria dhe Jugosllavia e kishin nënshkruar një traktat bashkëpunimi në Bled, lëvizje kjo që u kritikua ashpër nga Stalini (The Cominform Documents, 1947). Pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, krerët e PKSH kanë pohuar se ishin udhëheqësit e

Jugosllavisë ata që nuk lejuan që Hoxha ta takonte Stalinin më parë, por e vërteta ish se vetë Stalini i pat lënë dorë të lirë Jugosllavisë në Shqipëri.

### **Prishja e kësaj ideje**

Stalini, udhëheqësi i shtetit sovjetik, nuk dukej se kishte ndonjë interes të madh për Shqipërinë në vitet e pasluftës. Për Bashkimin Sovjetik, Shqipëria ishte thjesht një vend i vogël, me ekonomi të prapambetur, pa kurrfarë infrastrukture dhe, si e tillë, aspak joshës për fuqinë e madhe. Për këtë arsye e la Shqipërinë nën ndikimin e shtetit jugosllav. Kjo u vu re qartë kur më 10 shkurt të vitit 1948, në Moskë, u mbajt mbledhja e përfaqësuesve të Partive Komuniste të Bashkimit Sovjetik (Stalini), Bullgarisë (Dimitrovi) dhe Jugosllavisë (Gjilasi, krahu i djathtë i Titos). Në këtë mbledhje, ndër të tjera, u diskutua edhe për çështjen e vendosjes në krahinën e Korçës të një divizioni ushtarak jugosllav me pretekstin se gjoja do të mbronin kufirin juglindor të Shqipërisë, nga Greqia. Stalini u shpreh se ky do të ishte një gabim i madh nga ana e jugosllavëve, pasi Anglia dhe Amerika do e vënë re një diçka të tillë dhe do të pohojnë se Shqipëria është pushtuar. Kjo nuk është aspak e leverdisshme pasi nxit konfliktin ndërmjet dy kampëve. Më tej, Stalini i jep këshillë Jugosllavisë duke i thënë se varianti më i mirë për këtë ishte përfshirja e Shqipërisë në përbërjen e Jugosllavisë, nëpërmjet Federatës Ballkanike. “Një bashkim i tillë mund të bëhet që nesër, arsyetoi ai, por ai duhet të përgatitet me vendime parlamentare” (Smirnova 2004: 333).

Në historiografinë komuniste ky fakt është interpretuar si shkak kryesor i prishjes së marrëdhënieve të Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë. Enver Hoxha, sipas dokumenteve arkivore të kohës, pohon se ishte Shqipëria ajo që e njoftoi Bashkimin Sovjetik për këtë fakt. Me ta marrë këtë propozim qeveria shqiptare i raportoi qeverisë sovjetike këtë gjë, atëherë qeveria jugosllave e anuloi këtë veprim. Nga ana tjetër, Stalini kur takohet me E. Hoxhën në Moskë, në vitin 1949, i thotë atij se qeveria sovjetike nuk ishte në dijeni që jugosllavët donin të dërgonin

një divizion në Shqipëri (AMPJ 1949, D. 15: 3). Ndoshta Stalini e ka thënë këtë që mos të dilte keq në sytë e Enver Hoxhës, në një kohë kur Bashkimi Sovjetik i kishte prishur marrëdhëniet më Jugosllavinë.

“Grindja midis Jugosllavisë dhe partnerit të saj Sovjetik arriti kulmin me në një mbledhje të Byrosë Informative Komuniste (KOMINFORM) në Bukuresht. Më 28 qershor 1948 Partia Komuniste Jugosllave u akuzua për devijim nga vija e ashpër marksiste e Stalinit, pasi nuk kishte ndërmarrë masa të ashpra kundër fshatarëve të pasur” (Jacques 1995: 510). Në fakt thyerja Tito – Stalin nuk ndodhi vetëm për anashkalimin e luftës së klasave nga ana e Jugosllavisë, ky ishte vetëm një pretekst. E vërteta është se Tito nuk po i jepte më llogari Stalinit për sa i përket politikës së jashtme dhe të brendshme të shtetit të tij, kjo nuk i pëlqente aspak BRSS, që e konsideronte veten si të vetmin vend të cilit i takon udhëheqja e kampit komunist. Stalini nuk do ta shihte me sy të mirë forcimin gjithnjë e më të madh të shtetit jugosllav në Ballkan dhe politikën pothuajse asnjënjëse që po ndiqte Tito kohët e fundit.

Në 13 prill 1948 mbërriti në Shqipëri kopja e letrës së KQ të PK të BRSS-së e 27 marsit, që akuzonte PKJ dhe udhëheqësit e saj për vijën e tyre antisovjetike dhe antimarksiste (AQSH 1949, D. 18: 11). Shqipëria, nga ana e saj kishte kohë që ishte e pakënaqur nga pala jugosllave. Presioni që ushtronte qeveria jugosllave tek qeveria shqiptare, për ta përfshirë atë në Federatën Jugosllave ishte i padurueshëm, ndaj dëshira më e madhe e udhëheqësve shqiptarë ishte distancimi nga Jugosllavia. Kjo letër i erdhi si dhuratë nga qielli E. Hoxhës, i cili në kushtet e krijuara nuk kërkonte gjë tjetër veçse të distancohej nga ndikimi jugosllav.

Stalini filloi të interesohej për vendin tonë kur marrëdhëniet me Jugosllavinë po i vinte fundi. Në këtë rast Shqipëria do të kishte rëndësi të dorës së parë për sovjetikët pasi do i siguronte atyre daljen në detin Adriatik. Shqipëria kishte një pozitë të favorshme gjeografike, ajo ishte fqinje e Greqisë (zonë e influencës Britanike) dhe ishte vetëm pak kilometra në rrugë detare nga Italia. “Nga ana tjetër, pas prishjes së

marrëdhëniet sovjeto-jugosllave, edhe Stalinit i nevojitej një Shqipëri e pozicionuar kundër Jugosllavisë së Titos, për të ngushtuar rrethin e izolimit për udhëheqësin heretik jugosllav, që kishte guxuar ta kundërshtonte” (ASHSH 2008: 245). Në këto rrethana Shqipëria u bë gjithnjë e më tepër qendra e vëmendjes për sovjetikët.

Më 1 korrik 1948, qeveria shqiptare lajmëroi anulimin e marrëveshjeve me Jugosllavinë dhe largimin nga vendi të këshilltarëve jugosllavë. Kursi i ri politik, që zgjodhi vendi, nisi me spastrimet nga radhët e partisë. Prishjen e marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve Hoxha e përdori edhe si pretekst për të pastruar kabinetin qeveritar nga ata persona që e kërcënonin pushtetin e tij. Në këtë kuadër një sërë anëtarësh të Byrosë Politike, ndërmjet tyre edhe K. Xoxe, Ministër i Brendshëm u ekzekutuan me pretekstin se konsideroheshin tradhtarë të popullit pasi kishin bashkëpunuar me qeverinë jugosllave për të përmbysur qeverinë në pushtet. Kështu E. Hoxha bëri një lëvizje të zgjuar pasi u nda nga Jugosllavia duke i shprehur besnikërinë e tij BRSS dhe eliminoi kundërshtarët e tij politikë. Partia e Punës së Shqipërisë nuk ngurroi për asnjë sekond për t’u shkëputur nga ndikimi jugosllav. Kjo ishte shpëtimtare për regjimin komunist dhe për vetë Hoxhën personalisht.

### **Përfundim**

Bashkimi Sovjetik u kthye kështu në partnerin kryesor për Shqipërinë dhe do e ndihmonte atë në rrugën drejt komunizmit. “Ky mbrojtës i fuqishëm i interesonte Hoxhës, pasi duke qenë se BS-ja ishte shumë larg, ai do të ishte më i pavarur, gjë që nuk mund të ndodhte në rastin kur mbrojtës ishte Jugosllavia fqinje” (Duka 2007: 241). Duket se Shqipërisë jo vetëm që nuk i erdhi keq nga shkëputjet e marrëdhëniet me Jugosllavinë, përkundrazi ajo u ndie e çliruar prej tyre.

Marrëdhëniet e Bashkimit Sovjetik me Jugosllavinë do të kishin një ndikim të madh në marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik edhe në të ardhmen. Duket sikur këto marrëdhëniet ishin të pandara nga njëra tjetra. Pas prishjes së marrëdhëniet me Jugosllavinë, Shqipëria u

drejtua nga Bashkimi Sovjetik, duke gjetur tek ai një aleat politik dhe ekonomik.

**Bibliografia**

ARKIVI Qendror i Shtetit Shqiptar, F. 14, V. 1949.

ARKIVI i Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ), 1949.

ASHSH (2008), *Historia e Popullit Shqiptar, vëllimi IV*, Tiranë.

DUKA, Valentina (2007), *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë.

JACQUES, Edwin (1995), *Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Tiranë.

MALLTEZI, Luan & PLASARI, Ndreci (1996), *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave*, Tiranë.

SMIRNOVA, Nina (2004), *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë.

GURAKUQI, Romeo (2011), Problemi i federatës shqiptaro–jugosllave: *Mapo, Korrik*, Tiranë.

THE COMINFORM DOCUMENTS. Minutes of the Three Conferences 1947/48/49 (edited by Giuliano Procacci, in Fondazione Giangiacomo Feltrinelli, Annali, 1994, Feltrinelli Editore, Milano, ISBN 88-07-99050-4). Published on web June 13<sup>th</sup> 1999. Available at: <http://ml-review.ca/aml/Comintern/COMINFORM-NS.htm..>